

**NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE Departamenti i përgjithshëm,** me Gjyqtarin Gezim Ademi, procesmbajtëse Hasnije Muhaxheri, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurve S.K nga ... ku edhe tani jeton rruga ... ,i martuar, punëtor, serb ,shtetas i Republikës se Kosovës, ka qen arrest shtëpiak per shkak fe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 lidhur me 31 te KPRK-ës, dhe i pandehuri N.K, nga ... tani me vendbanim ne ... rr. ... nr. ... .., shtetas i Serbisë ka qene ne paraburgim për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1pika 1.1 lidhur me 31 te KPRK-ës, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr 752/2017, dt.19.04.2018, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt.25.04.2019, ne mungese te prokurorit e ne prezence te pandehurit ne te njëjtën date publikisht shpalli, e me datë 30.04.2019, merre këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit ;**

**I pandehuri: S.K , nga i ati M. e ëma G. e vajzërisë S. i lindur më ... në ..., ku edhe tani jeton rruga "... "nr. ..., i martuar baba i tre fëmijëve ,Serb , Shtetas i Republikës se Kosovës, i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike.**

**I pandehuri: N.K, nga i ati I., e ema J. , e vajzërisë K. i lindur ... ne ... tani me venbanim ne ..., rruga "... " nr. ... eshte i divorcuar dhe eshte i ve, Shtetas i Serbis, ka qene ne paraburgim.**

**JANE FAJTOR**

**SEPSE:** Me dt.24.09.2017 rreth orës 21.00 ne një aheng dasme ne restorantin "... " qe gjendet ne ... i kanë shkaktuar lëndime trupore te dëmtuarit M.G ne këtë mënyrë qe fillimisht te pandehurit kanë ftuar te dëmtuarin M. qe te dal jashtë restorantit ne mënyre qe kinse ta pyesin diçka dhe ne momentin i njëjti sipas thirrjes se këtyre ka dal para restorantit te pandehurit papritmas janë vërsulur ne drejtimin e tij ku i shkaktojnë ndrydhje te indeve te buta te kokës ne plagë qarëse gjak mbledhje nen lëkurore ne regjionin zbarkor te kokës dhe ne regjionin e mollzës se djathtë te fytyrës, gërvishtje dhe dërrmishje lëkurore ne regjioni e kofshës se këmbës se majtë dhe ne regjionin e gjurit te këmbës se djathtë e qe janë lëndime te lehta trupore ,

Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 par 1.1 lidhur me 31 te KPRK-se.

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 7,8,9,10,21,49,51,52,73, dhe 188 par.1 pika 1.1 lidhur me 31 te KPRK-ës dhe nenit 365, 450, 463 te KPP-ës i:

**G J Y K O N**

**Te pandehurin: S.K**

ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) vite.

### **Te pandehurin: N.K**

ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) vite.

Koha e kaluar ne paraburgim për te pandehurin N.K, nga data 24.09.2017, derime 27.09.2017, si dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak per te pandehurin S.K 24.09.2017, e deri me datën 20.10.2017, i'u llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

OBLIGOHEN te pandehurit qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj se cili veq e veq shumen prej 20 Euro, ne emër te ekspertizës mjeko-ligjore secili veq e veq shumen prej nga 10 euro, ndërsa për kompensimin e viktimave te krimet secili veq e veq shumen prej 30 euro, te cilat shpenzime te pandehurit janë te obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.752/2018, te dt.19.04.2018, kundër te pandehurve S.K nga ... dhe N.K nga ... me vendbanim ne ... për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 e lidhur me 31 te KPRK-es.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.25.04.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri S.K lidhur me fajësinë ka deklaruar: E ndjej veten fajtor për veprën penale qe me vihet ne bar dhe është hera e par ne jetën time qe ka ndodhur ky rast, dhe njëherit me vjen keq për rastin qe ka ndodhur jam thelle i penduar për këtë rast dhe i premtoj gjykatës qe kjo është hera e fundit qe kam kryer këtë vepër penale, dhe se jam mbajtës i familjes dhe e kam gruan shtatzane dhe pres fëmijën e katert për te cilin vazhdimisht duhem te kujdesem, i pandehuri N.K lidhur me fajësinë ka deklaruar se: e ndjej veten fajtor për këtë vepër penale dhe pendohem qe e e kam kryer këtë vepër, dhe me pare nuk kam qene i dënuar për vepër penale është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin, dhe njehrit i kërkoj falje te dëmtuarit dhe i premtoj gjykatës qe nuk do te kryej vepra te tilla as te ndryshme penale, dhe gjithherë e respektoj gjykatën dhe kam ardhur nga serbia qe te deklarohem për këtë seancë.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori deklaron: I propozoj gjykatës qe ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve pasi qe ishte me vullnet dhe pa presion dhe pranimi i fajësisë është ne përputhje te plote dhe me faktet qe gjenden ne aktakuzë dhe mbështet ne dispozitat

ligjore, janë plotësuar kushtet ligjore, e qe gjykata me rastin e shqiptimit te dënimit pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësues .

### **I. Vlerësimi i pranimit te fajësisë.**

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe te pandehurit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë te pandehurit e kane bere ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e Gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga te pandehurit është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga te pandehurit, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurve, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lëndës si: raportet policore si dhe shkresat tjera te lendes sipas nr. ... te dt. 24.09.2017, Konstatimet nga eksperti mjeko-ligjor e dt: 25.10.2017, dosja kriminale ne emër te pandehurve, si dhe vështrimi ne shkresat e tjera te lendes, nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurve vërtetohet se te pandehurit e kane kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188par 1 pika 1.1 lidhur me 31 te KPRK-se .

### **II. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.**

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me gjobe dhe me burgim deri ne në një (1)vit, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale. Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tyre me rastin e pranimit te fajësisë se te njëjtit deklarohen se e ndjejnë veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurve për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tyre për veprën penale, si rrethane tjetër lehtësuese ka gjetur se te njëjtit nuk ka qenë me parë te dënuar për ndonjë veprë tjetër penale. Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurve pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton ky dënim e qe ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

### **III. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.**

Lidhur me shpenzimet procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj se cili veq e veq shumen prej 20 Euro, ne emër te ekspertizës mjeko-ligjore secili veq e veq shumen prej nga 10 euro, ndërsa për kompensimin e viktimave te krimit secili veq e veq shumen prej 30 euro, te cilat shpenzime te pandehurit janë te obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

### **Lidhur me kërkesën pasurore juridike.**

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P. nr 304/2018 dt: 30.04.2019**

Procesmbajtësja :  
**Hasnije Muhaxheri**

Gjyqtari :  
**Gëzim Ademi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate